



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 21 maj 2012  
Nr. ref.: RK242/12

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI146/11**

Parashtruesi

**Isak Berisha**

**Kërkesë për zbatimin e dy rregulloreve të UNMIK-ut nr. 2001/35 dhe 2005/20**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është Isak Berisha nga Prishtina.

## **Kërkesa e parashtruesit**

2. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese “zbatimin e dy rregulloreve të UNMIK-ut nr. 2001/35 dhe 2005/20 dhe sidomos zbatimin e urdhërësës së Fondit Plotësues Pensional (suplementar-shtesë). Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/35 e ka nënshkruar Hans Hakerup, Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm, ndërsa Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/20 e ka nënshkruar Soren Jesen-Petersen, Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm.”

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesi i kërkesës nuk përmend ndonjë nen konkret të Kushtetutës që është shkelur, mirëpo moszbatimin e rregulloreve e konsideron shkelje të të drejtave. Nga kërkesa mund të konkludohet që objekt i çështjes është kontesti juridik në mes të parashtruesit të kërkesës dhe Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: PTK) që ka lindur si pasojë e mospagesës së sigurimit pensional plotësues, që sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ka vlerën 48000 Euro.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të datës 16 dhjetor 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës.

## **Procedura në Gjykatë**

5. Parashtruesi i kërkesës e parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 11 nëntor 2011.
6. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të marrë parasysh mbrojtjen e identitetit tij pa arsyetuar se përse ai ka nevojë për një mbrojtje të tillë.
7. Më 27 janar 2012, Gjykata Kushtetuese e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Komunale në Prishtinë se është iniciuar procedura e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së aktgjykimit në lidhje me lëndën nr. KI146-11.
8. Më 22 shkurt 2012, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Gjykatën e Qarkut në Prishtinë se është iniciuar procedura e shqyrtimit të kushtetutshmërisë në lidhje me lëndën nr. KI146-11.
9. Më 9 maj 2012, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarës Snezhana Botusharova, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues), Kadri Kryeziu dhe prof. dr. Enver Hasani i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Parashtruesi i kërkesës ishte në marrëdhënie pune me PTK-në deri në pensionimin e tij, kur me aktvendimin nr. 3280/07, të 8 gushtit 2007, ai u pensionua.
11. Gjatë kohës sa parashtruesi i kërkesës ishte në marrëdhënie pune me PTK-në, ai u anëtarësua në Fondin Plotësues Pensional të PTK-së që ishte formuara nga drejtori i PTK-së me Vendimin nr. 01-4083/02, të 29 korrikut 2002. Në bazë të vendimit, në pikën IV është paraparë se lartësia e Fondit Plotësues Pensional, të cilin plotësisht e ka

financuar PTK-ja, ishte caktuar në 10.1% të lartësisë bruto të të ardhurave personale mujore për të gjithë punëtorët e PTK-së. Pronarë të këtij fondi janë të gjithë punëtorët. Në rast të vdekjes së punëtorit para përmbushjes së kushteve për pension të pleqërisë, trashëgimtari i tij/saj mund të trashëgojë tërë shumën e kursimeve të grumbulluara. Secili punëtor mund të caktojë trashëgimtarin që do të trashëgojë kursimet. Nëse punëtori shpallet invalid, kursimet e tij mund të shfrytëzohen për pension.

12. Shuma në Fondin Plotësues Pensional nuk mund të tërhiqet përderisa përfituesi i fondit nuk i mbush 65 vjet, ose përndryshe mund të shfrytëzohet me rastin e pensionimit të parakohshëm për shkak të sëmundjes apo rrethanave tjera, nëse e ka përmbushur kushtin prej 35 vjet stazh pune.
13. Shpenzimet për këtë fond seriozisht kanë rrezikuar vlerën e PTK-së për një periudhë afatgjate, dhe për këto arsye fondi i PTK-së u mbyll më 31 dhjetor 2005 me pajtimin e Autoriteti Qendror Bankar të Kosovës (në tekstin e mëtejme: AQBK).
14. Obligimet e krijuara ndaj punëtorëve në bazë të sigurimit plotësues të themeluar në këtë mënyrë u transferuan në tri fonde pensionale, me ç'rast secili punëtor ka pasur të drejtë, sipas dëshirës së tij, të zgjedhë njërin nga këto fonde pensionale:
  - ACP -Siguruesi i Pensioneve Plotesuese Individuale Amerikano-Kosovar;
  - FSKP -Fondi Slloven Kosovar i Pensioneve; dhe
  - TKPK -Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës.
15. Në bazë të dokumentacionit të parashtruar mund të supozohet se parashtruesi i kërkesës zgjodhi si fond pensional TKPK - Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.
16. Pas pensionimit, parashtruesi i kërkesës iu drejtua me shkrim personave përgjegjës në PTK në emër të tij, por edhe si anëtar i Bordit të drejtorëve të sindikatës së pavarur të PTK-së, me kërkesë që PTK t'ia shlyejë obligimet e krijuara me formimin e sigurimit plotësues pensional.
17. Në një nga përgjigjet e dhëna në emër të PTK-së nga Menaxheri Special, Suzana Vokshi, në të cilën i sqaron të drejtat e parashtruesit të kërkesës në raport me Fondin Plotësues Pensional të PTK-së (në tekstin e mëtejme: Fondi i PTK-së), ku parashtruesi i kërkesës ishte anëtar deri më 31 dhjetor 2005, thuhet se:
 

*“Bazuar në të dhënat e paraqitura më poshtë dhe sipas ligjeve të Fondit të PTK-se vlera e të drejtave tuaja në fondin e PTK-së deri më 31 dhjetor 2005 ka shumën prej 22921.3 euro në këtë shumë nuk është llogaritur kamata prej 4% prej 1 janarit 2006 deri me datën e transferimit të mjeteve në skemën e re pensionale. Taksat do të ndahen nga mjetet e transferuara sipas ligjeve të obligueshme në fuqi.”*
18. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë me të cilën kërkon që PTK t'ia paguajë shpërblimet jubilarë në shumën prej dy pagave bazë.
19. Duke vendosur në lidhje me padinë e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin C. nr. 770/2009, të 23 shkurtit 2011, e pranoi padinë e parashtruesit të kërkesës dhe me aktgjykim e obligoi PTK-në që parashtruesit të kërkesës t'ia paguajë në emër të shpërblimit jubilar shumën prej 3499,22, në emër të kontributit pensional shumën 190,87 Euro dhe në emër të tatimit në pagë shumën prej 330,85 Euro, dhe të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita kur aktgjykimi merr formë të prerë.

20. Sipas parashtruesit ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 770/2009, të 23 shkurtit 2011, PTK-ja është ankuar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Lënda u regjistrua me nr. Pl. 377/2011 dhe sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lënda “gjendet në procedurë gjyqësore pranë Gjykatës së Qarkut”.
21. Më 1 gusht 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi të re në Gjykatën Komunale në Prishtinë, të regjistruar me nr. C 1756 /2011, me të cilën kërkoi që PTK-ja, në bazë të skemës pensionale, t’ia paguajë shumën prej 48.000 Euro, dhe e tërë kjo në bazë të një studimi të kryer nga firma Deloitte and Touche. Kjo lëndë gjendet në procedurë gjyqësore në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

22. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me këto kërkesa:

*“Kërkoj zbatimin e plotë të dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/20 për ndryshimin e Rregullores nr. 2001/35 për pensionet në Kosovë dhe zbatimin e Urdhërësës e Fondit Plotësues Pensional (suplementar-shtesë) Aneks „B“ BPK-A, (Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës) të 24.04.2006, që të përmbushen dhe zbatohen në tërësi Vendimet e Bordit të Drejtorëve të PTK-së nr. 05-987/06 dhe 07/06...”*

*“E lus Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës që ta kërkojë regjistrin e përfituesve nga fondi plotësues pensional (Suplementar shtesë) nga posta dhe telekomunikacioni i Kosovës, nga drejtori menaxhues z. Shyqyri Haxha dhe Besnik Jani dhe nga z. Gani Gurguri, guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës dhe nga Suzana Vokshi, menaxhere speciale e cila e ka regjistrin e përfituesve plotësues.*

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

23. Për të qenë në gjendje të vendos për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë. Në lidhje me këtë kërkesë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parashikon si në vijim:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

24. Gjykata e thekson se arsyetimi për kërkesën e shterimit është që t’iu ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ Selmouni kundër Francës, nr. 25803194, Vendim i datës 28 korrik 1999). Sidoqoftë, nuk është e domosdoshme që të drejtat kushtetuese të ngritën në mënyrë eksplicite gjatë procedurave në fjalë. Deri sa kjo çështje është ngritur në mënyrë implicite ose substanciale, kërkesa për shterimin e mjeteve është plotësuar (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Azinas kundër Qipros, nr. 56679/00, Vendimi i datës 28 prill 2004).
25. Kjo Gjykatë e ka përdorur të njëjtin arsyetim me rastin e marrjes së Vendimit për papranueshmëri të datës 27 janar 2010 mbi bazën e mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në rastin Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K, Prishtinë, kundër Qeverisë së

Republikës së Kosovës, lënda nr. KI. 41/09 dhe Vendimit të 23 marsit 2010 në rastin Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lënda nr. KI 73/09.

26. Duke pasur parasysh se në bazë dokumentacionit të parashtruar në Gjykatën Kushtetuese nga ana e parashtruesit të kërkesës, Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 770/2009, i 23 shkurtit 2011, nuk është i formës së prerë dhe se në bazë të ankesës së PTK-së është duke u zhvilluar procedura në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë me nr. Pl.377/2011, e cila ende nuk ka përfunduar, si dhe duke pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës më 1 gusht 2011 ka ushtruar padi të re në Gjykatën Komunale në Prishtinë, të regjistruar me nr. C 1756, e cila po ashtu nuk ka përfunduar. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj ashtu që të mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.
27. Nga kjo del se kërkesa nuk është e pranueshme për shqyrtim në pajtim me nenin 113.7 dhe rregullin 36 (1a) të Rregullores së punës, i cili parashikon se, *“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: a) janë shterur të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar...”*.
28. Më tej, përderisa parashtruesi i kërkesës insiston që Gjykata Kushtetuese të vendosë në mënyrë meritore në lidhje me kërkesën e tij për zbatimin e dy rregulloreve të UNMIK-ut nr. 2001/35 dhe 2005/20, Gjykata Kushtetuese vëren se, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e rregullt për të vendosur në lidhje me kontestet në shkallën e parë, gjë e cila është kompetencë e gjykatave të rregullt, në të cilat parashtruesi i kërkesës ka iniciuar procedurat.
29. Gjykata Kushtetuese po ashtu vëren se “zbatimi i dy rregulloreve të UNMIK-ut nr. 2001/35 dhe 2005/20”, nuk bie në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, prandaj një kërkesë e tillë nuk është në pajtim me *ratione materiae* të Gjykatës Kushtetuese, pasi që në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese hyjnë procedura që kanë të bëjnë me shkeljen e pretenduar të Kushtetutës.

### PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 56 (2), 36 (1a) dhe 36 (3f) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 9 maj 2012, Gjykata Kushtetuese, njëzëri:

### VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t’u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani